

## G.5 REDAKTUESI I REGJISTRIMIT

Redaktuesi i regjistrimit në dritaren **CORES** funksionon ngjashëm me redaktuesin e regjistrimit në dritaren **Regjistrimi bibliografik**.

Në menunë **Regjistrimi** janë në dispozicion këto metoda për administrimin e regjistrimeve nga baza e të dhënave CORES: redaktimi i regjistrimit, shkarkimi, verifikimi automatik, ruajtja e përkohëshme, ruajtja e regjistrimit si model për regjistrimin e ri dhe ruajtja e regjistrimit. Metodat, të cilat për regjistrimet nga baza CORES nuk përdoren, nuk janë aktive.

---

### G.5.1 Administrimi i regjistrimeve

Në bazën e të dhënave CORES regjistrimet shkarkohen nga COBIB-i. Mund të shkarkohen vetëm regjistrimet për burimet në vazhdim, përkatësisht vetëm fushat të cilat janë të nevojshme për identifikimin bazë të burimit. Metoda **Regjistrimi / Shkarko regjistrimin** është e vetmja metodë, me anë të së cilës në CORES mund të shtoni regjistrimet (metoda **Regjistrimi / Krijo regjistrimin** nuk është aktive).